



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.199

dhjetor

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 039 datë 22.12.2008	Për ndihmën juridike 10821
Ligj nr.10 041 datë 22.12.2008	Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore” 10827
Ligj nr.10 042 datë 22.12.2008	Për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar 10840

LIGJ
Nr.10 039, datë 22.12.2008

PËR NDIHMËN JURIDIKE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, për mbrojtjen e lirive e të të drejtave themelore të individit, si dhe të interesave të tjerë të ligjshëm të tij.

Neni 2
Parimet themelore për dhënien e ndihmës juridike

Dhënia e ndihmës juridike nga shteti për individët mbështetet në parimet:

- a) e barazisë së të drejtave për të gjithë individët, që përfitojnë nga ndihma juridike;
- b) e profesionalizmit të personave, që japin ndihmën juridike;
- c) e cilësisë, efikasitetit dhe efektivitetit të shërbimit të ndihmës juridike;
- ç) e ruajtjes së konfidencialitetit;
- d) e papranueshmërisë së konfliktit të interesit.

KREU II
ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË NDIHMËS JURIDIKE

Neni 3
Administrimi

Shërbimi i ndihmës juridike për individët, të dhënë nga shteti, është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë, e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe e Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Neni 4
Detyrat e Ministrisë së Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a) zhvillon politikën shtetërore;
- b) ndihmon në përgatitjen e akteve të nevojshme ligjore/nënligjore, në bashkëpunim me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndhmën Juridike;
- c) kujdeset për zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore dhe ndihmon në vlerësimin e cilësisë së ndihmës juridike të dhënë;
- ç) përgatit projektbuxhetin, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, në fushën e shërbimit të ndihmës juridike për individët, kryen këto detyra:

- a) merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për përzgjedhjen e avokatëve, që do të japin këtë ndihmë;
- b) merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e cilësisë së shërbimit të dhënë nga avokatët;
- c) merr masa disiplinore ndaj avokatëve, që japin ndihmë juridike, në përputhje me ligjin nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 6

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike

1. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike është organ shtetëror kolegjal dhe ka statusin e personit juridik publik.

2. Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, nga të cilët njëri zgjidhet nga Ministri i Drejtësisë, njëri nga Ministri i Financave, njëri nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, i katërti nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe i pesti nga organizatat jofitimprurëse, që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Anëtari nga organizatat jofitimprurëse zgjidhet prej 4 anëtarëve të zgjedhur më sipër, nga lista e kandidatëve të propozuar nga këto organizata.

3. Mandati i anëtarëve të komisionit është 4-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje të menjëhershme vetëm një herë.

4. Komisioni është organ kolegjal, me kohë të pjesshme, me përjashtim të kryetarit, i cili është funksionar me kohë të plotë.

5. Asistenca teknike, logjistike dhe financiare sigurohen nga sekretariati i komisionit.

6. Komisioni organizohet dhe funksionon sipas rregullores së brendshme, që propozohet prej tij dhe miratohet nga Ministri i Drejtësisë.

7. Paga e kryetarit të komisionit është e njëjtë me pagën e zëvendësministrit, ndërsa shpërblimi i anëtarëve, struktura e komisionit, organika dhe niveli i pagave të sekretariatit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 7

Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i komisionit dhe kryetar i tij

1. Anëtar i komisionit mund të zgjidhet personi që:

- a) ka shtetësi shqiptare;
- b) ka zotësi të plotë për të vepruar;
- c) ka mbaruar arsimin e lartë juridik, ekonomik ose menaxhim publik;
- ç) gëzon një figurë të pastër morale dhe përgatitje të lartë profesionale;
- d) ka një përvojë jo më pak se 5 vjet në profesion.

2. Kryetari i komisionit emërohet në detyrë me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, pasi është marrë më parë mendimi i Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Kryetari i komisionit duhet të ketë arsim të lartë juridik.

3. Kryetari i komisionit lirohet nga detyra me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, me propozimin e Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

4. Detyra e kryetarit është e papajtueshme me çdo detyrë tjetër shtetërore ose private.

Neni 8

Lirimi i anëtarëve të komisionit

Lirimi nga detyra i anëtarit të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike bëhet nga organi që

e ka emëruar kur:

- a) jep dorëheqjen;
- b) mbush moshën e pensionit;
- c) dënohet me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;
- ç) ndërpret marrëdhëniet e punës me institucionin që e ka emëruar;
- d) nuk merr pjesë, pa arsye, në më shumë se tri mbledhje rresht të komisionit;
- dh) i mbaron mandati i qëndrimit në detyrë.

Neni 9

Fuqia detyruese e vendimeve

Vendimet e marra nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike janë detyruese për zbatim nga avokatët që japin ndihmën juridike, sipas këtij ligji. Në rast të moszbatimit të tyre, komisioni ka të drejtë të kërkojë marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve, sipas ligjit nr.9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 10

Detyrat e komisionit

Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike kryen këto detyra:

- a) zbaton politikën shtetërore në dhënien e ndihmës juridike për individët;
- b) menaxhon buxhetin e dhënë për ofrimin e ndihmës juridike nga shteti;
- c) miraton rregullat e caktimit të avokatëve, zyra të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse, që do të ofrojnë ndihmën juridike dhe kujdeset për zbatimin e tyre;
- ç) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet për ofrimin, nga ana e shtetit, të ndihmës juridike dhe ia paraqet Ministrit të Drejtësisë, për t'u përfshirë në Buxhetin e Shtetit;
- d) lidh kontratat e shërbimit me avokatët, zyrat e avokatisë dhe organizatat jofitimprurëse, që do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike;
- dh) vendos masën e shpërblimit të avokatëve në ofrimin e ndihmës juridike ndaj individëve, pasi të ketë marrë më parë mendimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Drejtësisë, por, në çdo rast, shpërblimet duhet të jenë jo më të vogla se tarifat e miratuara për shërbimin e avokatisë;
- e) paraqet, në fund të çdo viti, raportin vjetor para Ministrit të Drejtësisë, Ministrit të Financave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe raporton sa herë që i kërkohet;
- ë) përcakton dhe rishikon standardet e ndihmës juridike, si dhe kujdeset për trajnimet profesionale për avokatët që japin këtë ndihmë;
- f) bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organizatat jofitimprurëse, vendase ose të huaja, që veprojnë në fushën e ndihmës juridike;
- g) vendos kriteret, në bazë të të cilave do të vlerësohet cilësia e shërbimit të ndihmës juridike të dhënë;
- gj) mban të dhëna për personat, që përfitojnë ndihmë juridike dhe boton, në fund të çdo viti, buletin statistikor për to;
- h) merr vendim dhe urdhëron kryerjen e pagesës së avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, pas paraqitjes së dokumenteve, që përcaktohen me vendim të veçantë;
- i) cakton përparësitë për çështjet, për të cilat ofrohet ndihmë juridike, me kufizimet e imponuara për shkak të burimeve dhe mjeteve financiare në dispozicion;
- j) bashkërendon sistemin e ndihmës juridike, duke përfshirë ofrimin e saj në të gjitha format.

KREU III

SHËRBIMET E NDIHMËS JURIDIKE DHE PËRFITUESIT E SAJ

Neni 11

Ndihma juridike dhe përfituesit

1. Ndihma juridike nga shteti jepet nga avokatët e autorizuar, sipas këtij ligji, në kushtet e

përcaktuara në këtë ligj dhe në formën e ndihmës juridike parësore e të ndihmës juridike dytësore.

Ndihma juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera.

Ndihma juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe të paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

2. Ndihma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në medien e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë.

Neni 12

Format e dhënies së ndihmës juridike

Ndihma juridike jepet nëpërmjet:

- a) sigurimit të informacionit, dhënies së këshillimeve dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë;
- b) plotësimit të akteve juridike;
- c) këshillimit në vazhdimësi të personave që paraqiten vetë në gjykatë;
- ç) përfaqësimit para organeve administrative;
- d) mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të të dyshuarit, të të akuzuarit dhe të të dëmtuarit në procesin penal;
- dh) mbrojtjes dhe përfaqësimit të interesave të personave në çështjet civile ose administrative.

Neni 13

Personat që kanë të drejtë të përfitojnë ndihmë juridike

1. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat, të cilët:

a) kërkojnë të mbrohen me avokat në procesin penal në të gjitha fazat e tij dhe, për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë mundur të zgjedhin një avokat apo kanë mbetur pa të;

b) kanë nevojë për ndihmë juridike në çështjet civile ose administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme për ta paguar këtë ndihmë juridike apo çështjet janë tepër komplekse, nga ana e përmbajtjes dhe e procedurës. Në këtë rast, personi, që ta përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet se përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet për t'u përfshirë në to.

2. Ndihmën juridike e përfitojnë edhe të miturit, për të cilët mbrojtja në procedimin penal dhe në gjykim është e detyrueshme me ligj.

3. Ndihma juridike mund të kërkohet para, gjatë dhe pas zhvillimit të procesit gjyqësor.

4. Personi, i cili përfiton ndihmë juridike, ka detyrimin të bashkëpunojë me avokatin, që siguron ndihmën juridike, të japë informacion të vërtetë, për të cilin është kërkuar ndihma juridike, si dhe të sigurojë në kohë çdo informacion për rrethanat dhe kushtet, që kanë ndryshuar shkakun e dhënies së ndihmës.

5. Moszbatimi i pikës 4 të këtij neni nga personi, që përfiton ndihmën juridike për çështjet civile ose administrative, përbën shkak për ndërprerjen e menjëhershme të përfitimit të kësaj ndihme juridike.

Neni 14

Kthimi i shpenzimeve për ndihmën juridike të dhënë

1. Në rast se përfituesi i ndihmës juridike, në përfundim të procesit gjyqësor, përfiton rimbursimin e shpenzimeve gjyqësore të parapaguara, ai detyrohet t'i kthejë Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike shpenzimet e kryera nga ky i fundit, për ofrimin e ndihmës juridike në çështjen përkatëse.

2. Personi që ka përfituar ndihmë juridike, duke paraqitur të dhëna të rreme ose të pavërteta, përfshirë edhe të dhënat për gjendjen e tij financiare, është i detyruar të kthejë të gjitha shpenzimet e kryera për ofrimin e kësaj ndihme.

3. Kthimi i shpenzimeve, sipas pikës 2 të këtij neni, bëhet sipas urdhrin të lëshuar nga Kryetari

i Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike. Urdhri i kryetarit të komisionit përbën titull ekzekutiv dhe ngarkohet shërbimi i përmbarimit gjyqësor për ekzekutimin e tij.

Neni 15

Ofrimi i ndihmës juridike

1. Ndhma juridike në çështjet civile dhe administrative jepet duke pasur parasysh:
 - a) vlerën relative të ankesës apo pasurisë së përfshirë;
 - b) bazueshmërinë në ligj të argumenteve ligjore dhe pretendimeve, të cilat paraqiten në emër të kërkuarit apo përfituesit;
 - c) mundësinë e suksesit të ankesës apo të mbrojtjes;
 - ç) kompleksitetin e çështjes;
 - d) aftësinë e kërkuarit apo të përfituesit, që të vetëpërfaqësohet.
2. Dhënia e ndihmës juridike nuk refuzohet në çështjet penale, parashikuar nga pika 1 shkronja “a” dhe pika 2 e nenit 13 të këtij ligji.

KREU IV

PROCEDURA PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE

Neni 16

Paraqitja e kërkesës

1. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike, në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, duhet të paraqitet personalisht nga kërkuari apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë. Formulari i kërkesës dhe dokumentet shoqëruese përcaktohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.
2. Kërkesa për dhënie e ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, nuk i nënshtrohet asnjë forme. Ajo mund të paraqitet edhe gojarisht te personi i autorizuar për dhënie e ndihmës juridike apo për caktimin e ofruesit të kësaj ndihme.
3. Rregullat e hollësishme në zbatim të pikave 1 e 2 të këtij neni, për paraqitjen e kërkesave, përcaktohen nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike.

Neni 17

Refuzimi i dhënies së ndihmës juridike

1. Organi, që ka të drejtën e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike, është Kryetari i Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike. Ndaj vendimit të kryetarit mund të bëhet ankim në Komisionin Shtetëror për Ndhmën Juridike brenda 10 ditëve nga data e njoftimit të tij.
2. Kundër vendimit të refuzimit të dhënies së ndihmës juridike mund të bëhet ankim në gjykatën që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Neni 18

Vendimi i refuzimit të dhënies së ndihmës juridike

1. Vendimi për refuzimin e dhënies së ndihmës juridike duhet të përmbajë:
 - a) datën dhe vendin e vendimit;
 - b) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 - c) formën e ndihmës juridike të kërkuar;
 - ç) arsyet e refuzimit të dhënies së ndihmës juridike;
 - d) procedurën e ankimit;
 - dh) të dhëna të tjera të nevojshme.
2. Avokati i caktuar për të dhënë ndihmën juridike mund të zëvendësohet nga komisioni:
 - a) nëse paraqitet kërkesa me shkrim nga vetë personi i interesuar për zëvendësimin e tij;
 - b) me kërkesë të avokatit të caktuar për dhënie e ndihmës juridike;
 - c) në rast të konfliktit të interesit.

Neni 19

Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

1. Organizatat jofitimprurëse, të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, japin ndihmë juridike me avokatë, duke respektuar përcaktimet e bëra në këtë ligj.
2. Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike lidh kontratë bashkëpunimi me këto organizata, për të mundësuar dhënien e ndihmës juridike, në përputhje me format dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj.

Neni 20

Avokatët që japin ndihmë juridike

1. Ndihma juridike parësore dhe ndihma juridike dytësore jepen vetëm nga personat që ushtrojnë profesionin e avokatit.
2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike përcaktojnë listën e avokatëve që autorizohen, në përputhje me këtë ligj, të japin ndihmë juridike, si dhe vendin e shtrirjes së veprimtarisë së tyre. Nëse është e nevojshme, komisioni dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë mund të organizojnë konkurs për përcaktimin e avokatëve që do të japin ndihmë juridike.
3. Lista e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike, bëhet publike.

Neni 21

Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike

1. Kontrolli i cilësisë së ndihmës juridike të ofruar realizohet nga Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike. Me kërkesë të të interesuarit, kryesisht apo me kërkesë të Ministrit të Drejtësisë, komisioni verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike për një rast konkret dhe, në bazë të rezultateve, ka të drejtë të zgjidhë kontratën e shërbimit me avokatin e autorizuar për dhënien e ndihmës juridike.
2. Forma dhe standardet e kontrollit miratohen me vendim të Komisionit Shtetëror për Ndhmën Juridike.
3. Rezultatet e kontrollit i dërgohen Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe mund të shërbejnë si bazë për marrjen e masave disiplinore ndaj avokatëve.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22
Buxheti

1. Dhënia e ndihmës juridike parësore dhe e ndihmës juridike dytësore përballohen nga Buxheti i Shtetit ose edhe nga burime të tjera të ligjshme.
2. Fondet për dhënien e ndihmës juridike përbëjnë zë të veçantë në buxhetin e Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike.

Neni 23

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 7 të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 3 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5997, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 041, datë 22.12.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008
“PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË TARIFËS DOGANORE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Nivelet tarifore të disa artikujve, të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet ligjit nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, ndryshojnë sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5999, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

ANEKSI - 1

Kodi NK	Përshkrimi	Tarifa	Tarifa
---------	------------	--------	--------

2008		(%) ishte	(%) bëhet
6403 12 00	-- Çizmet e skive, çizmet e skive per ski malore dhe cizmet per debore	15	10
6403 19 00	-- Te tjera	15	10
6403 20 00	-- Veshje kembe me shuallin e jashtem prej lekure, dhe suprinen qe perbehet nga rripa lekure permes harkut te kembes dhe rreth gishtit te madh	15	10
6403 40 00	-- Veshje te tjera kembe, me nje maje mbrojtese metalike	15	10
6403 51 05	---- Te bere mbi nje bazament apo platforme prej druri, qe nuk kane shuall te brendshem.	15	10
6403 51 11	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 51 15	----- Per burra	15	10
6403 51 19	----- Per gra	15	10
6403 51 91	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 51 95	----- Per burra	15	10
6403 51 99	----- Per gra	15	10
6403 59 05	---- Te bere mbi nje bazament apo platforme prej druri, qe nuk kane shuall te brendshem	15	10
6403 59 11	----- Me sholle dhe take te kombinuar me gjatesi me shume se 3 cm	15	10
6403 59 31	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 59 35	----- Per burra	15	10
6403 59 39	----- Per gra	15	10
6403 59 50	----- Shapka dhe veshje te tjera kembesh per brenda ne shtepi	15	10
6403 59 91	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 59 95	----- Per burra	15	10
6403 59 99	----- Per gra	15	10
6403 91 05	---- Te bere mbi nje bazament apo platforme prej druri, qe nuk kane shuall te brendshem	15	10
6403 91 11	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 91 13	----- Veshje te kembes te cilat nuk mund te idendifikohen si veshje kembe per gra apo per burra	15	10
6403 91 16	----- Per burra	15	10
6403 91 18	----- Per gra	15	10
6403 91 91	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 91 93	----- Veshje te kembes te cilat nuk mund te idendifikohen si veshje kembe per burra apo per gra	15	10
6403 91 96	----- Per burra	15	10
6403 91 98	----- Per gra	15	10
6403 99 05	---- Te bere mbi nje bazament apo platforme prej druri, qe nuk kane shuall te brendshem	15	10
6403 99 11	----- Me sholle dhe take te kombinuar qe kane gjatesi me shume se 3 cm	15	10
6403 99 31	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 99 33	----- Veshje te kembes te cilat nuk mund te idendifikohen si veshje kembe per burra apo per gra	15	10
6403 99 36	----- Per burra	15	10
6403 99 38	----- Per gra	15	10
6403 99 50	----- Shapka apo veshje kembe te tjera per brenda ne shtepi	15	10
6403 99 91	----- Me pak se 24 cm	15	10
6403 99 93	----- Veshje te kembes te cilat nuk mund te idendifikohen si veshje kembe per burra apo per gra	15	10
6403 99 96	----- Per burra	15	10

6403 99 98	----- Per gra	15	10
7206 10 00	– Lingota	2	0
7206 90 00	– Te tjera	2	0
7207 11 11	----- Prej celiku me prerje te shpejte	2	0
7207 11 14	----- Te nje trashesie jo me teper se 130 mm	2	0
7207 11 16	----- Te nje trashesie me teper se 130 mm	2	0
7207 11 90	---- Te farketuara	2	0
7207 12 10	---- Te petezuara apo te fituara nepermjet derdhjeve te vazhdueshme	2	0
7207 12 90	---- Te farketuara	2	0
7207 19 12	----- Te petezuara apo te perftuar me derdhje te panderprere	2	0
7207 19 19	----- Te farketuara	2	0
7207 19 80	---- Te tjera	2	0
7207 20 11	----- Prej celiku me prerje te shpejte	2	0
7207 20 15	----- 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon	2	0
7207 20 17	----- 0,6 % apo me shume karbon	2	0
7207 20 19	---- Te farketuara	2	0
7207 20 32	---- Te petezuara apo te fituara nepermjet derdhjeve te vazhdueshme	2	0
7207 20 39	---- Te farketuara	2	0
7207 20 52	---- Te mbeshjtelle apo te fituar nga derdhje e vazhdueshme	2	0
7207 20 59	---- Te farketuara	2	0
7207 20 80	-- Te tjera	2	0
7208 10 00	– Ne spirale, jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, te pjese ne strukture	2	0
7208 25 00	-- Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume	2	0
7208 26 00	-- Te nje trashesie prej 3 mm apo me shume por me pak sesa 4,75 mm	2	0
7208 27 00	-- Te nje trashesie prej me pak se 3 mm	2	0
7208 36 00	-- Te nje trashesie prej me teper se 10 mm	2	0
7208 37 00	-- Me trashesi 4,75 mm ose me shume por qe nuk e kalon 10 mm	2	0
7208 38 00	-- Me trashesi 3 mm ose me shume por me pak se 4,75 mm	2	0
7208 39 00	-- Me trashesi me pak se 3 mm	2	0
7208 40 00	– Jo ne spirale, jo i punuar me tej se i mbeshjtelle ne te nxehte, me dizenjo ne relief	2	0
7208 51 20	---- Me trashesi qe e kalon 15 mm	2	0
7208 51 91	----- 2050 mm apo me shume	2	0
7208 51 98	----- Me pak se 2050 mm	2	0
7208 52 10	---- Te petezuara ne te kater anet apo ne nje kalim kutie te mbyllur, te nje gjeressie jo me teper se 1250mm	2	0
7208 52 91	----- 2 050 mm ose me teper	2	0
7208 52 99	----- Me pak se 2 050 mm	2	0
7208 53 10	---- Te petezuara ne te kater anet apo ne nje kalim kutie te mbyllur, te nje gjeressie jo me teper se 1250mm dhe te nje trashesie 4mm apo me shume	2	0
7208 53 90	---- Te tjera	2	0
7208 54 00	-- Me trashesi me pak se 3 mm	2	0
7208 90 20	-- Te perforuara	2	0
7208 90 80	-- Te tjera	2	0
7209 15 00	-- Te nje trashesie prej 3 mm apo me shume	2	0
7209 16 10	---- 'Elektrike'	2	0
7209 16 90	---- Te tjera	2	0
7209 17 10	---- 'Elektrike'	2	0
7209 17 90	---- Te tjera	2	0
7209 18 10	---- 'Elektrike'	2	0

7209 18 91	----- Te nje trashesie prej 0,35 mm apo me shume por me pak se 0,5 mm	2	0
7209 18 99	----- Te nje trashesie prej me pak se 0,35 mm	2	0
7209 25 00	-- Te nje trashesie prej 3 mm apo me shume	2	0
7209 26 10	---- 'Elektrike'	2	0
7209 26 90	---- Te tjera	2	0
7209 27 10	---- 'Elektrike'	2	0
7209 27 90	---- Te tjera	2	0
7209 28 10	---- 'Elektrike'	2	0
7209 28 90	---- Te tjera	2	0
7209 90 20	-- Te perforuara	2	0
7209 90 80	-- Te tjera	2	0
7210 11 00	-- Me trashesi 0,5 mm ose me shume	2	0
7210 12 20	---- Kallajisur (veshur me kallaj)	2	0
7210 12 80	---- Te tjera	2	0
7210 20 00	- Veshur me plumb, perfshire dhe terneplated	2	0
7210 30 00	- Te veshura me zink me elektrolize	2	0
7210 41 00	-- E valezuar	2	0
7210 49 00	-- Te tjera	2	0
7210 50 00	- Veshur me okside kromi ose me krom dhe okside kromi	2	0
7210 61 00	-- Veshur me lidhje zinkalumin	2	0
7210 69 00	-- Te tjera	2	0
7210 70 10	-- I kallaisur, i llustruar;produkte,te veshur apo mbuluar me okside kromi apo me krom dhe okside kromi, te llustruara	2	0
7210 70 80	-- Te tjera	2	0
7210 90 30	-- I veshur	2	0
7210 90 40	-- Kallajisur dhe stampuar	2	0
7210 90 80	-- Te tjera	2	0
7211 13 00	-- E petezuar ne te kater faqet apo ne nje kaliber te mbyllur kendedrejte, te nje gjeresie me teper se 150 mm dhe te nje trashesie prej jo me pak se 4 mm, jo ne bobina dhe pa dizenje ne relief	2	0
7211 14 00	-- Te tjera, me trashesi 4,75 mm ose me shume	2	0
7211 19 00	-- Te tjera	2	0
7211 23 20	---- 'Elektrike'	2	0
7211 23 30	----- Me trashesi 0,53 mm ose me shume	2	0
7211 23 80	----- Me trashesi me pak ses 0,53 mm	2	0
7211 29 00	-- Te tjera	2	0
7211 90 20	-- Te perforuara	2	0
7211 90 80	-- Te tjera	2	0
7212 10 10	-- Pllake kallaji, jo me tej te punuara sesa te trajtuara ne siperfaqe	2	0
7212 10 90	-- Te tjera	2	0
7212 20 00	- Te veshura me zink me elektrolize	2	0
7212 30 00	- I veshur me zink me te tjera menyra	2	0
7212 40 20	-- I kallaisur, jo punuar me tej se llustruar;produkte,te veshur apo mbuluar me okside kromi apo me krom dhe okside kromi,te llustruara	2	0
7212 40 80	-- Te tjera	2	0
7212 50 20	-- Te veshur apo te mbuluar me okside kromi apo me krom dhe okside kromi	2	0
7212 50 30	-- Veshur me krom ose nikel	2	0
7212 50 40	-- Veshur me baker	2	0
7212 50 61	---- Veshur me lidhje zinkalumin	2	0
7212 50 69	---- Te tjera	2	0

7212 50 90	-- Te tjera	2	0
7212 60 00	-- I veshur	2	0
7213 10 00	-- Qe permbajne dhembhezime, brazda, flanxha apo deformime te tjera te prodhuara prej procesit te petezimit	5	0
7213 20 00	-- Te tjera, prej celik automati	5	0
7213 91 10	---- Te nje lloji te perdorur per perforcimin e betonit	5	0
7213 91 20	---- Te nje lloji te perdorur per tasat e rrotave	5	0
7213 91 41	----- Qe permbajne ndaj peshes 0,06 % apo me pak karbon	5	0
7213 91 49	----- Qe permbajne ndaj peshes me shume se 0,06 % por me pak se 0,25 % karbon	5	0
7213 91 70	----- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume por jo me shume se 0,75 % karbon	5	0
7213 91 90	----- Qe permbajne ndaj peshes me shume se 0,75 % karbon	5	0
7213 99 10	---- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 0,25 % karbon	5	0
7213 99 90	---- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume karbon	5	0
7214 10 00	-- Te farketuara	5	0
7214 20 00	-- Qe permbajne dhembhezime, brazda, flanxha apo deformime te tjera te prodhuara gjate procesit te petezimit apo te perdredhura pas petezimit	5	0
7214 30 00	-- Te tjera, prej celiku te punueshem	5	0
7214 91 10	---- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 0,25 % karbon	5	0
7214 91 90	---- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume karbon	5	0
7214 99 10	---- Te nje lloji te perdorur zakonisht per perforcimin e betonit	5	0
7214 99 31	----- 80 mm apo me shume	5	0
7214 99 39	----- Me pak se 80 mm	5	0
7214 99 50	----- Te tjera	5	0
7214 99 71	----- 80 mm ose me shume	5	0
7214 99 79	----- Me pak se 80 mm	5	0
7214 99 95	----- Te tjera	5	0
7215 10 00	-- Prej celik automati, jo me tej te punuara sesa te formuar ne te ftohte apo te perfunduara ne te ftohte	5	0
7215 50 11	---- Te seksionit kryq drejtkendeshe (ndryshe nga katrore)	5	0
7215 50 19	---- Te tjera	5	0
7215 50 80	-- Qe permban 0,25% ose me shume karbin ne peshe	5	0
7215 90 00	-- Te tjera	5	0
7216 10 00	-- Profile U, i apo H, jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte, te nje lartesis me pak se 80 mm	5	0
7216 21 00	-- Profile L	5	0
7216 22 00	-- Profile T	5	0
7216 31 10	---- Me lartesi 80 mm ose me shume por qe nuk e kalon 220 mm	5	0
7216 31 90	---- Me lartesi qe e kalon 220 mm	5	0
7216 32 11	----- Me faqe paralele te perthyera	5	0
7216 32 19	----- Te tjera	5	0
7216 32 91	----- Me faqe paralele te perthyera	5	0
7216 32 99	----- Te tjera	5	0
7216 33 10	---- Te nje lartesis prej 80 mm apo me shume por jo me teper se 180 mm	5	0
7216 33 90	---- Te nje lartesis me teper se 180 mm	5	0
7216 40 10	-- Profile L	5	0
7216 40 90	-- Profile T	5	0
7216 50 10	-- Me nje seksion kryq i cili eshte ne gjendje te jete i mbyllur ne nje katror ana e te cilit eshte 80 mm	5	0

7216 50 91	--- Bulb flats	5	0
7216 50 99	--- Te tjera	5	0
7216 61 10	--- Profile C, L, U, Z, omega apo me funde te hapura	5	0
7216 61 90	--- Te tjera	5	0
7216 69 00	-- Te tjera	5	0
7216 91 10	--- Fleta te profiluara (ne shirrita)	5	0
7216 91 80	--- Te tjera	5	0
7216 99 00	-- Te tjera	5	0
7217 10 10	--- Me nje maksimum te dimensionit kryq seksional prej me pak se 0,8 mm	5	0
7217 10 31	----- Qe permbajne cepa, te dala, shtremberime apo deformime te tjera te prodhuara gjate procesit te petezimit	5	0
7217 10 39	----- Te tjera	5	0
7217 10 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon	5	0
7217 10 90	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,6 % apo me shume karbon	5	0
7217 20 10	--- Me nje maksimum te seksionit kryq seksional prej me pak se 0,8 mm	5	0
7217 20 30	--- Me nje maksimum te seksionit kryq seksional prej 0,8 mm apo me shume	5	0
7217 20 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon	5	0
7217 20 90	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,6 % apo me shume karbon	5	0
7217 30 41	--- Veshur me baker	5	0
7217 30 49	--- Te tjera	5	0
7217 30 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon	5	0
7217 30 90	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,6 % apo me shume karbon	5	0
7217 90 20	-- Qe permban me pak se 0.25% karbon ne peshe	5	0
7217 90 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,25 % apo me shume por me pak se 0,6 % karbon	5	0
7217 90 90	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,6 % apo me shume karbon	5	0
7218 10 00	- Lingota dhe forma te tjera primare	2	0
7218 91 10	--- Qe permban 2.5% ose me shume nikel ne peshe	5	0
7218 91 80	--- Qe permban me pak se 2.5% nikel ne peshe	5	0
7218 99 11	----- Te petezuara apo te fituara nepermjet derdhjeve te vazhdueshme	5	0
7218 99 19	----- Te farketuara	5	0
7218 99 20	----- Te petezuara apo te fituara nepermjet derdhjeve te vazhdueshme	5	0
7218 99 80	----- I farketuar	5	0
7219 11 00	-- Te nje trashesie me teper se 10 mm	5	0
7219 12 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 12 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 13 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 13 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 14 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 14 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 21 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 21 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 22 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 22 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 23 00	-- Te nje trashesie prej 3 mm apo me shume por me pak se 4,75 mm	5	0
7219 24 00	-- Te nje trashesie prej me pak se 3 mm	5	0

7219 31 00	-- Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume	5	0
7219 32 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 32 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 33 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 33 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 34 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 34 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 35 10	--- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7219 35 90	--- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7219 90 20	-- Te perforuara	5	0
7219 90 80	-- Te tjera	5	0
7220 11 00	-- Te nje trashesie prej 4,75 mm apo me shume	5	0
7220 12 00	-- Te nje trashesie prej me pak se 4,75 mm	5	0
7220 20 21	---- me 2.5% nikel apo me shume	5	0
7220 20 29	---- Me me pak se 2.5% nikel	5	0
7220 20 41	---- me 2.5% nikel ose me shume	5	0
7220 20 49	---- Me me pak se 2.5% nikel	5	0
7220 20 81	---- me 2.5% nikel ose me shume	5	0
7220 20 89	---- Me me pak se 2.5% nikel	5	0
7220 90 20	-- Te perforuara	5	0
7220 90 80	-- Te tjera	5	0
7221 00 10	- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7221 00 90	- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 11 11	----- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 11 19	----- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 11 81	----- Me 2,5% nikel ose me shume	5	0
7222 11 89	----- Me me pak se 2,5% nikel	5	0
7222 19 10	---- Qe permbajne ndaj peshes 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 19 90	---- Qe permbajne ndaj peshes me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 20 11	----- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 20 19	----- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 20 21	----- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 20 29	----- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 20 31	----- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 20 39	----- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 20 81	---- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 20 89	---- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 30 51	---- 2,5 % apo me shume nikel	5	0
7222 30 91	---- Me pak se 2,5 % nikel	5	0
7222 30 97	-- Te tjera	5	0
7222 40 10	-- Jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte	5	0
7222 40 50	-- Jo te punuara me shume se perpunimi ne te ftohte	5	0
7222 40 90	-- Te tjera	5	0
7223 00 11	-- Qe permbajne ndaj peshes 28 % apo me shume por jo me shume se 31 % nikel dhe 20 % apo me shume por jo me shume se 22% krom	5	0
7223 00 19	-- Te tjera	5	0
7223 00 91	-- Qe permbajne ndaj peshes 13 % apo me shume por jo me shume se 25 % krom dhe 3,5 % apo me shume por jo me shume se 6 % alumin	5	0
7223 00 99	-- Te tjera	5	0
7224 10 10	-- Prej celiku per vegla	2	0
7224 10 90	-- Te tjera	2	0

7224 90 02	-- Prej celiku per vegla	5	0
7224 90 03	----- Prej celiku highspeed	5	0
7224 90 05	----- Qe permbajne ndaj peshes jo me shume se 0,7 % karbon, 0,5 % apo me shume por jo me shume se 1,2 % manganez dhe 0,6 % apo me shume por jo me shume se 2,3 % silikon; qe permbajne ndaj peshes 0,0008 % apo me shume bor me cdo element tjeter me pa	5	0
7224 90 07	----- Te tjera	5	0
7224 90 14	----- Te tjera	5	0
7224 90 18	----- I farketuar	5	0
7224 90 31	----- Qe permbajne ndaj peshes jo me pak se 0,9 % por jo me shume se 1,15 % karbon, jo me pak se 0,5 % por jo me shume se 2 % krom dhe, nese eshte prezent, jo me shume se 0,5 % molibden	5	0
7224 90 38	----- Te tjera	5	0
7224 90 90	----- I farketuar	5	0
7225 11 00	-- Te orientuara sipas strukture natyrale	5	0
7225 19 10	--- Te petezuara ne te nxehte	5	0
7225 19 90	--- Te petezuara ne te ftohte	5	0
7225 30 10	-- Prej celiku per vegla	5	0
7225 30 30	-- Prej celiku highspeed	5	0
7225 30 90	-- Te tjera	5	0
7225 40 12	-- Prej celiku per vegla	5	0
7225 40 15	-- Prej celiku highspeed	5	0
7225 40 40	--- Me trashesi me te madhe se 10 mm	5	0
7225 40 60	--- Me trashesi 4,75 mm ose me shume por qe nuk e kalon 10 mm	5	0
7225 40 90	--- Me trashesi me pak se 4,75 mm	5	0
7225 50 20	-- Prej celiku highspeed	5	0
7225 50 80	-- Te tjera	5	0
7225 91 00	-- Te veshura me zink me elektrolize	5	0
7225 92 00	-- I veshur me zink me metoda te tjera	5	0
7225 99 00	-- Te tjera	5	0
7226 11 00	-- Me karakter te orientuar	5	0
7226 19 10	--- Jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte	5	0
7226 19 80	--- Te tjera	5	0
7226 20 00	-- Prej celiku instrumental shpejtpreres	5	0
7226 91 20	--- Prej celiku per vegla	5	0
7226 91 91	----- Me trashesi 4,75 mm ose me shume	5	0
7226 91 99	----- Me trashesi me pak se 4,75 mm	5	0
7226 92 00	-- Jo me shume te perpunuara se petezimi ne te ftohte	5	0
7226 99 10	--- Te veshura me zink me elektrolize	5	0
7226 99 30	--- I veshur me zink me metoda te tjera	5	0
7226 99 70	--- Te tjera	5	0
7227 10 00	-- Prej celiku me prerje te shpejte	5	0
7227 20 00	-- Prej celiku silicomanganez	5	0
7227 90 10	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,0008 % apo me shume boron me cdo element tjeter me pak se minimumi i permbajtjes se referuar ne shenimin 1(f) te ketij kapitulli	5	0
7227 90 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,9 % apo me shume por jo me shume se 1,15 % karbon, 0,5% apo me shume por jo me shume se 2% krom dhe, nese eshte prezent, jo me shume se 0,5 % molibden	5	0
7227 90 95	-- Te tjera	5	0
7228 10 20	-- Jo i punuar me tej se mbeshtjelle ne te nxehte, I leshuar ne te nxehte apo shtrydhur; me mbeshtjelle ne te nxehte apo i leshuar ne te nxehte apo	5	0

	shtrydhur,jo punuar me tej se i veshur		
7228 10 50	-- Te farketuara	5	0
7228 10 90	-- Te tjera	5	0
7228 20 10	-- Me seksion terthor drejtkendesh (jo katror), i petezuar ne te ftohte ne te kater faqet	5	0
7228 20 91	---- Jo i punuar me tej se mbeshjtjelle ne te nxehte,I leshuar ne te nxehte apo shtrydhur;mbeshjtjelle ne te nxehte leshuar ne te nxehte apo shtrydhur,jo punuar me tej se i veshur	5	0
7228 20 99	---- Te tjera	5	0
7228 30 20	-- Prej celiku per vegla	5	0
7228 30 41	---- Te seksionit kryq seksional rrethor te nje diametri prej 80 mm apo me shume	5	0
7228 30 49	---- Te tjera	5	0
7228 30 61	----- 80 mm apo me shume	5	0
7228 30 69	----- Me pak se 80 mm	5	0
7228 30 70	---- Te seksionit kryq seksional drejtkendesh (ndryshe nga katrori), te rrumbullakosura ne te kater faqet	5	0
7228 30 89	---- Te tjera	5	0
7228 40 10	-- Prej celiku veglash	5	0
7228 40 90	-- Te tjera	5	0
7228 50 20	-- Prej celiku veglash	5	0
7228 50 40	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,9 % apo me shume por jo me shume se 1,15% karbon, 0,5% apo me shume por jo me shume se 2 % krom dhe, nese eshte present, jo me shume se 0,5 % molibden	5	0
7228 50 61	----- 80 mm apo me shume	5	0
7228 50 69	----- Me pak se 80 mm	5	0
7228 50 80	---- Te tjera	5	0
7228 60 20	-- Prej celiku instrumental	5	0
7228 60 80	-- Te tjera	5	0
7228 70 10	-- Jo me tej te punuara sesa te petezuara ne te nxehte, te terhequra ne te nxehte apo te stampuara ne te nxehte	5	0
7228 70 90	-- Te tjera	5	0
7228 80 00	-- Kallepe dhe thupra per trapane hollow	5	0
7229 20 00	-- Prej celiku silicomanganez	5	0
7229 90 20	-- Prej celiku high speed	2	0
7229 90 50	-- Qe permbajne ndaj peshes 0,9 % apo me shume por jo me shume se 1,15% karbon, 0,5% apo me shume por jo me shume se 2 % krom dhe, nese eshte present, jo me shume se 0,5 % molibden	5	0
7229 90 90	-- Te tjera	5	0
7301 10 00	-- Pllaka mberthimi	5	0
7301 20 00	-- Kende, forma dhe seksione	5	0
7302 10 10	-- Me ndjekje te vazhdueshme, me pjese prej metale jofferike	5	0
7302 10 21	----- Me peshe specifike 46 kg/m ose me shume	2	0
7302 10 23	----- Me peshe specifike 27 kg/m ose me shume por me pak se 46 kg/m	2	0
7302 10 29	----- Me peshe per meter me pak se 27 kg	2	0
7302 10 40	----- Shine ne forme ulluku	2	0
7302 10 50	----- Te tjera	2	0
7302 10 90	---- Te perdorura	5	0
7302 40 00	-- Pllake bashkuese dhe sole plates	2	0
7302 90 00	-- Te tjera	2	0
7303 00 10	-- Tuba dhe tubacione te nje lloji te perdorur ne sistemet e presionit	0	0

7303 00 90	– Te tjera	0	0
7304 11 00	-- Prej celiku te pandryshkshem	2	0
7304 19 10	---- Te nje diametri te jashtem jo me teper se 168,3 mm	2	0
7304 19 30	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 168,3 mm, por jo me teper se 406,4 mm	2	0
7304 19 90	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 406,4 mm	2	0
7304 22 00	-- Linja shpimi prej celiku te pandryshkshem	2	0
7304 23 00	-- Te tjera linja shpimi	2	0
7304 24 00	-- Te tjera, prej celiku te pandryshkshem	2	0
7304 29 10	---- Te nje diametri te jashtem jo me teper se 168,3 mm	2	0
7304 29 30	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 168,3 mm, por jo me teper se 406,4 mm	2	0
7304 29 90	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 406,4 mm	2	0
7304 31 20	---- Tubat e precizionit:	2	0
7304 31 80	---- Te tjera:	2	0
7304 39 10	---- Te papunuara, te drejta dhe me trashesi uniforme te mureve, per perdorim vetem ne prodhimin e tubave dhe tuacioneve me te tjera profile dhe trashesi muresh	5	0
7304 39 30	----- Te nje diametri te jashtem me teper se 421 mm dhe te nje trashesie muresh me teper se 10,5 mm:	5	0
7304 39 52	----- Te pllakezuara apo te veshura me zink:	2	0
7304 39 58	----- Te tjera	2	0
7304 39 92	----- Jo me teper se 168,3mm	2	0
7304 39 93	----- Me teper se 168,3 mm por jo me teper se 406,4 mm	5	0
7304 39 99	----- Me teper se 406,4 mm	5	0
7304 41 00	-- Te terhequr ne te ftohte apo te petezuar ne te ftohte:	2	0
7304 49 10	---- Te papunuara, te drejta dhe me trashesi muresh uniforme, per perdorim vetem ne prodhimin e tubave dhe tubacioneve me seksion kryq fdhe trashesi muresh tjeter	5	0
7304 49 93	---- Te nje diametri te jashtem jo me teper se 168,3 mm	2	0
7304 49 95	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 168,3 mm por jo me teper se 406,4 mm	2	0
7304 49 99	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 406,4 mm	5	0
7304 51 12	---- Qe nuk e kalon 0.5 m	2	0
7304 51 18	---- Qe e kalon 0.5 m	2	0
7304 51 81	---- Tubat e precizionit	2	0
7304 51 89	---- Te tjera	2	0
7304 59 10	---- Te papunuara, te drejta dhe me trashesi muresh uniforme, per perdorim vetem ne prodhimin e tubave dhe tubacioneve me seksion kryq dhe trashesi muresh tjeter	5	0
7304 59 32	---- Qe nuk e kalon 0.5 m	2	0
7304 59 38	---- Qe e kalon 0.5 m	2	0
7304 59 92	---- Te nje diametri te jashtem jo me teper se 168,3 mm	2	0
7304 59 93	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 168,3 mm por jo me teper se 406,4 mm	5	0
7304 59 99	---- Te nje diametri te jashtem me teper se 406,4 mm	5	0
7304 90 00	– Te tjera:	2	0
7305 11 00	-- Hark gjatesor i fundosur i salduar	5	0
7305 12 00	-- Te tjera, te salduar per se gjati	5	0
7305 19 00	-- Te tjera	5	0
7305 20 00	– Detale te derdhura te nje lloji te perdorur per shpim nafte e gaz	2	0
7305 31 00	-- Te salduar per se gjati	5	0

7305 39 00	-- Te tjera	5	0
7305 90 00	- Te tjera	5	0
7306 11 10	---- Te salduar per se gjati	2	0
7306 11 90	---- Te salduar ne forme spirale	2	0
7306 19 10	---- Te salduar per se gjati	2	0
7306 19 90	---- Te salduar ne forme spirale	2	0
7306 21 00	-- Te salduar, prej celiku te pandryshkshem	2	0
7306 29 00	-- Te tjera	2	0
7306 30 11	---- Jo me teper se 2 mm	2	0
7306 30 19	---- Me teper se 2 mm	2	0
7306 30 41	----- Te pllakezuar apo te veshur me zink	2	0
7306 30 49	----- Te tjera	2	0
7306 30 72	----- Te pllakezuar apo te veshur me zink	2	0
7306 30 77	----- Te tjera	2	0
7306 30 80	----- Me teper se 168,3 mm, por deri 406,4 mm	2	0
7306 40 20	-- Te terhequra ne te ftohte apo te petezuara ne te ftohte	2	0
7306 40 80	-- Te tjera	2	0
7306 50 20	-- Tuba precizioni	2	0
7306 50 80	-- Te tjera	2	0
7306 61 10	---- Prej celiku te pandryshkshem	2	0
7306 69 10	---- Prej celiku inoks	2	0
7306 90 00	- Te tjera	5	0
7307 11 10	---- Te nje lloji te perdorur ne sistemet e presionit	5	0
7307 11 90	---- Te tjera	5	0
7307 19 10	---- Prej gize te derdhur pasqyre	5	0
7307 19 90	---- Te tjera	5	0
7307 21 00	-- Flanxha	5	0
7307 23 10	---- Brrylat dhe perkuljet	5	0
7307 23 90	---- Te tjera	5	0
7307 29 10	---- Te filetuara	5	0
7307 29 30	---- Per saldim	5	0
7307 29 90	---- Te tjera	5	0
7307 91 00	-- Flanxha	5	0
7307 93 11	----- Brrylat dhe perkuljet	5	0
7307 93 19	----- Te tjera	5	0
7307 93 91	----- Brrylat dhe perkuljet	5	0
7307 93 99	----- Te tjera	5	0
7307 99 10	---- Te filetuara	5	0
7307 99 30	---- Per saldim	5	0
7307 99 90	---- Te tjera	5	0
7308 10 00	- Urat dhe seksionet e urave	5	0
7308 20 00	- Kullat dhe shtylla per grilla	5	0
7308 30 00	- Dyer, dritare dhe skeletet e tyre dhe pragjet per dyert	5	0
7308 40 10	-- Meteriale per armaturat e minierave	5	0
7308 40 90	-- Te tjera	5	0
7308 90 10	-- Digat mbrojtese, portat kontrolluese te rrjedhjes se ujit, portat mbyllese, pragjet e ankorimit, doqe te fiksuara dhe struktura te tjera detare dhe ujore	5	0
7308 90 51	----- Panele te perbera prej dy mureve flete te profiluara (te vazezuara) me nje berthame izoluese	5	0
7308 90 59	----- Te tjera	5	0
7308 90 99	---- Te tjera	5	0

7312 10 20	-- Prej celiku inoks	2	0
7312 10 41	----- Te pllakezuara apo te veshura me lidhjet bakerzink (Tunxh)	2	0
7312 10 49	----- Te tjera	2	0
7312 10 61	----- Te pavesura	2	0
7312 10 65	----- Te lyera ose veshura me zink	2	0
7312 10 69	----- Te tjera	2	0
7312 10 81	----- Mbi 3 mm por deri 12 mm	2	0
7312 10 83	----- Mbi 12 mm por deri 24 mm	2	0
7312 10 85	----- Mbi 24 mm por deri 48 mm	2	0
7312 10 89	----- Mbi 48 mm	2	0
7312 10 98	----- Te tjera	2	0
7312 90 00	- Te tjera:	2	0
7313 00 00	Tela te dhembzuar prej gize apo celiku; unaza te perdredhura apo telat te vetem te sheshte, te dhembzuar apo jo, dhe telat e dubluara lehtesisht te perdredhura, te nje lloji te perdorur per gardhe, prej gize apo celiku.	5	0
7314 12 00	-- Shirritat pafund per makinerite, prej celiku te pandryshkshem	5	0
7314 14 00	-- Veshje te tjera te endura, prej celiku te pandryshkshem	5	0
7314 19 00	-- Te tjera	5	0
7314 20 10	-- Prej teli te valezuar	5	0
7314 20 90	-- Te tjera	5	0
7314 31 00	-- Te pllakezuara apo te veshura me zink	5	0
7314 39 00	-- Te tjera	5	0
7314 41 10	---- Rrjeta hegzakonale	5	0
7314 41 90	---- Te tjera	5	0
7314 42 10	---- Rrjeta hegzakonale	5	0
7314 42 90	---- Te tjera	5	0
7314 49 00	-- Te tjera	5	0
7314 50 00	- Metale te zgjerueshme	5	0
7317 00 10	- Maja vizatuese	5	0
7317 00 20	---- Gozhde ne shirrita apo ne bobina	5	0
7317 00 40	---- Gozhde prej celiku qe permbajn ndaj peshes 0,5 % apo me shume karbon, te forcuar	5	0
7317 00 61	----- Te pllakezuara apo te veshura me zink	5	0
7317 00 69	----- Te tjera	5	0
7317 00 90	-- Te tjera	5	0
7401 00 00	Metalinat e bakrit; baker i cimentuar (baker i precipituar):	10	0
7402 00 00	Baker i parafinuar; anodat e bakrit per rafinimin elektrolitik.	10	0
7403 11 00	-- Katodat dhe seksionet e katodave	10	0
7403 12 00	-- Telashufra	10	0
7403 13 00	-- Lingote e petezuar	10	0
7403 19 00	-- Te tjera	10	0
7403 21 00	-- Lidhjet me baze bakerzink (tunxh)	10	0
7403 22 00	-- Lidhjet me baze bakerkallaj (bronz)	10	0
7403 29 00	-- Lidhje te tjera bakri (perveçse master lidhjeve te kreut Nr. 7405)	10	0
7404 00 10	- Prej bakri te rafinuar	10	0
7404 00 91	-- Prej lidhjeve bakerzink (tunxh)	10	0
7404 00 99	-- Te tjera	10	0
7405 00 00	Master lidhjet e bakrit.	10	0
7406 10 00	- Pluhura te struktures jo me shtresa	10	0
7406 20 00	- Pluhura te struktures me shtresa; feteza	10	0
7407 10 00	- Prej bakri te rafinuar	10	0
7407 21 10	---- Shufra dhe shkopinj	10	0

7407 21 90	--- Profile	10	0
7407 29 10	--- Te lidhjeve me baze bakernikel (kupronikel) apo te lidhjeve me baze bakernikelzink (argjend i nikeluar)	10	0
7407 29 90	--- Te tjera	10	0
7408 11 00	-- Prej te cileve dimensiononi kryq seksional maksimal e kalon te 6 mm	2	0
7408 19 10	--- Prej te cileve dimensiononi maksimal kryq seksional i tejkalon 0,5 mm	10	0
7408 19 90	--- Prej te cileve dimensiononi maksimal kryq seksional nuk i kalon 0,5 mm	10	0
7408 21 00	-- Prej lidhjeve me baze bakerzink (tunxh)	10	0
7408 22 00	-- Prej lidhjeve me baze bakernikel (kupronikel) apo lidhjeve me baze bakernikelzink (argjend i nikeluar)	10	0
7408 29 00	-- Te tjera	10	0
7409 11 00	-- Ne spirale	10	0
7409 19 00	-- Te tjera	10	0
7409 21 00	-- Ne spirale	10	0
7409 29 00	-- Te tjera	10	0
7409 31 00	-- Ne spirale	10	0
7409 39 00	-- Te tjera	10	0
7409 40 10	-- Prej lidhjeve me baze bakernikel (kupro nikel)	10	0
7409 40 90	-- Prej lidhjeve me baze bakernikelzink (argjend nikeli)	10	0
7409 90 00	-- Prej lidhjeve te tjera te bakrit	10	0
7410 11 00	-- Prej bakri te rafinuar	10	0
7410 12 00	-- Prej lidhjeve te bakrit	10	0
7410 21 00	-- Prej bakri te rafinuar	10	0
7410 22 00	-- Prej lidhjeve te bakrit	10	0
7411 10 11	--- Me teper se 0,6 mm	0	0
7411 10 19	--- Jo me teper se 0,6 mm	0	0
7411 10 90	-- Te tjera	0	0
7411 21 10	--- Te drejta	0	0
7411 21 90	--- Te tjera	0	0
7411 22 00	-- Prej lidhjeve me baze bakernikel (kupronikel) apo lidhjeve me baze bakernikelzink (argjend i nikeluar)	0	0
7411 29 00	-- Te tjera	0	0
7412 10 00	-- Prej bakri te rafinuar	10	0
7412 20 00	-- Prej lidhjeve te bakrit	10	0
7413 00 20	-- Prej bakri te rafinuar	10	0
7413 00 80	-- Prej lidhjeve te bakrit	10	0
7415 10 00	-- Gozhde, pineska, maja vizatuese, kunj me veshe dhe artikuj te ngjashem	10	0
7415 21 00	-- Rondelet (perfshire rondelet suste)	10	0
7415 29 00	-- Te tjera	10	0
7415 33 00	-- Vidha ; bulona dhe dado	10	0
7415 39 00	-- Te tjera	10	0
7418 11 00	-- Pastruese tenxheresh dhe mbushjet pastruese, dorezat dhe artikuj te ngjashem per pastrim apo llustrim:	10	0
7418 19 10	--- Aparate per gatim apo per ngrohje te nje lloji te perdorur per qellime shtepiake, jo elektrike, dhe pjeset prej tyre	10	0
7418 19 90	--- Te tjera	10	0
7418 20 00	-- Artikujt sanitare dhe pjeset prej tyre	10	0
7419 10 00	-- Zinxhirat dhe pjeset e tyre	10	0
7419 91 00	-- Te derdhura, te dhene forme, te stampuara apo te farketuara, por jo me tej te punuara	10	0
7419 99 10	--- Veshjet (perfshire shirritat pafund), grillat dhe rrjetat, prej telave	10	0

	nga te cilet asnje dimesion kryqseksional nuk i kalon 6mm; metal i zgjerueshem		
7419 99 30	--- Susta	10	0
7419 99 90	--- Te tjera	10	0
8536 70 00	- bashkues fibrash optike, lidhez fibrash optike ose kablo:	2	0

LIG J

Nr.10 042, datë 22.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME E SHITESA NË LIGJIN NR.8957, DATË 17.10.2002 "PËR NDËRMARRJET E VOGLA E TË MESME", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 "Për ndërmarrjet e vogla e të mesme", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 3 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 3

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- "Ndërmarrje" quhet çdo subjekt, që ushtron një veprimtari ekonomike, pavarësisht formës së tij ligjore. Këtu përfshihen personat e vetëpunësuar, bizneset familjare, që merren me artizanat ose veprimtari të tjera, si dhe shoqëritë e shoqatat, që kryejnë, në mënyrë të rregullt, veprimtari ekonomike.

- "Shifër afarizmi" nënkupton shumat e faturuara nga ndërmarrja gjatë një viti, që i korrespondojnë shitjes në treg të të mirave dhe shërbimeve ofruar të tretëve.

- "Shoqëri kapitali" janë shoqëritë aksionare, që kanë për objekt investimin e kapitalit në ndërmarrjet e vogla e të mesme.

- "Investimi i kapitalit të përbashkët" është investimi i kapitalit të përbashkët në ndërmarrjet e vogla e të mesme, në çastin e krijimit të tyre ose në fazën e tyre fillestare të zhvillimit.

- "Fonde të zhvillimit rajonal" janë ato fonde, që sigurojnë mbështetje financiare për zhvillimin e rajoneve në fusha të caktuara, si: investimet në kapacitetet e prodhimit, ndërtimi dhe modernizimi i infrastrukturës, investimet në fushën e kujdesit shëndetësor dhe të edukimit etj.

- "Ndërmarrje të vogla e të mesme të reja" vlerësohen ato ndërmarrje të vogla e të mesme, të cilat janë regjistruar në QKR prej jo më shumë se 12 muajsh.

- "Biznese të pakutuara" ("*business angels*") janë ato sipërmarrje individuale që u ofrojnë kapital në shuma të vogla bizneseve, aty ku bankat apo fondet financiare nuk kanë interes të futen dhe këtë e ofrojnë në këmbim të një pjese të aksioneve të kompanisë.

- "Treg i lidhur" ("*adjacent market*") është tregu i produkteve apo shërbimeve në diversifikim, të vendosura direkt sipër ose poshtë tregut përkatës."

Neni 2

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

1. Ndërmarrjet klasifikohen në: mikrondërmarrje, ndërmarrje të vogla dhe ndërmarrje të mesme.

2. Kategoria e mikrondërmarrjeve dhe ndërmarrjeve të vogla e të mesme (NVM) përfshin ato ndërmarrje, ku punësohen më pak se 250 veta dhe që realizojnë një shifër afarizmi dhe/ose një bilanc total vjetor jo më të madh se 250 milionë lekë.

3. Ndërmarrje e vogël quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 50 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 50 milionë lekë.

4. Mikrondërmarrje quhet një ndërmarrje, ku punësohen më pak se 10 persona dhe e cila ka një shifër afarizmi dhe/ose bilanc total vjetor jo më të madh se 10 milionë lekë.

5. Për qëllime statistikore ndërmarrjet do të klasifikohen në:

a) mikrondërmarrje: 0 deri 9 persona, ku brenda këtij grupimi të detajohen në 0-1 persona dhe 2-9 persona;

b) ndërmarrje të vogla: 10 deri 49 persona;

c) ndërmarrje të mesme: 50 deri 249 persona.”.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1, 4/2, 4/3, 4/4, 4/5, 4/6, 4/7 e 4/8 me këtë përmbajtje:

“Neni 4/1

1. “Ndërmarrje autonome” quhet ajo ndërmarrje që:

a) është totalisht e pavarur dhe që nuk ka asnjë pjesëmarrje në kapitalin ose të drejtat e votës në një ndërmarrje tjetër dhe anasjelltas;

b) mund të ketë disa investitorë, të cilët zotërojnë secili më pak se 25 për qind të kapitalit apo të të drejtave të votës, por me kusht që të mos jenë të lidhur në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji;

c) nuk klasifikohet si ndërmarrje partnere, në bazë të kuptimit të nenit 4/2 ose si ndërmarrje e lidhur, në bazë të neneve 4/1 pika 2 dhe 4/3 të këtij ligji.

2. Një ndërmarrje mund të vlerësohet autonome edhe në rastet kur nuk ka asnjë ndërmarrje partnere, megjithëse pragu i 25 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës arrihet apo tejkalohet nga investitorët e mëposhtëm, me kusht që këta investitorë të mos jenë të lidhur, në kuptim të nenit 4/3 të këtij ligji:

a) personat juridikë publikë, shoqëritë e kapitalit dhe individë apo grupe individësh me një veprimtari të rregullt investimi kapital, që investojnë aksione në biznese të pakuotura (“*business angels*”), me kushtin që totali i investimeve të këtyre bizneseve të pakuotura (“*business angels*”), në të njëjtën ndërmarrje, të jetë më pak se 30 milionë lekë;

b) universitetet dhe qendrat kërkimore jofitimprurëse;

c) investitorët institucionalë, përfshirë fondet e zhvillimit rajonal;

ç) autoritetet vendore me buxhet vjetor më të ulët se 50 milionë lekë dhe me më pak se 5 000 banorë.

Në çdo rast, pragu nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e kapitalit ose e të drejtave të votës, me kushtin që investitorët e mësipërm të mos jenë të lidhur, individualisht ose bashkërisht, me ndërmarrjen në fjalë.

Neni 4/2

“Ndërmarrje partnere” janë të gjitha ndërmarrjet, që nuk klasifikohen si ndërmarrje të lidhura dhe ndërmarrjet të cilave ekziston marrëdhënia si më poshtë:

- Një ndërmarrje zotëron vetëm ose bashkë me një apo më shumë ndërmarrje të lidhura 25 për qind apo më shumë të kapitalit ose të të drejtave të votës, por, në çdo rast, jo më shumë se 50 për qind të kapitalit ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër.

Neni 4/3

“Ndërmarrje të lidhura” janë ato ndërmarrje, të cilat kanë një ose disa prej marrëdhënieve të mëposhtme me njëra-tjetrën:

a) një ndërmarrje zotëron pjesën më të madhe të aksioneve ose të të drejtave të votës në një ndërmarrje tjetër;

b) një ndërmarrje ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë pjesën më të madhe të anëtarëve të organeve administrative, drejtuese ose mbikëqyrëse të një ndërmarrjeje tjetër;

c) një ndërmarrje ka të drejtë të ushtrojë ndikim dominues mbi një ndërmarrje tjetër, sipas kontratës, që ka lidhur me atë ndërmarrje, ose sipas një dispozite në statusin e shoqërisë;

ç) një ndërmarrje, e cila si aksionare ose anëtare e një ndërmarrjeje tjetër, kontrollon e vetme, sipas një marrëveshjeje me aksionarët ose anëtarët e tjerë të asaj ndërmarrjeje, shumicën e të drejtave të votës mbi bazë aksionesh ose anëtarësh në atë ndërmarrje.

Neni 4/4

1. Presumohet se nuk ekziston asnjë ndikim dominues, nëse investitorët e listuar në pikën 2 të nenit 4/1 këtij ligji nuk përfshihen vetë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në menaxhimin e ndërmarrjes në fjalë, pa paragjykim për të drejtat e tyre si aksionarë.

2. Ndërmarrje të lidhura janë edhe ato, që kanë ndonjërin nga marrëdhëniet e përsëhkuara në nenin 4/3, nëpërmjet një ose më shumë ndërmarrjeve të tjera apo ndonjë nga investitorëve, të përmendur në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji.

3. Ndërmarrjet, që i lidhin një ose disa marrëdhënie të tilla me një person fizik ose grup personash fizikë, që veprojnë bashkërisht, vlerësohen, gjithashtu, ndërmarrje të lidhura, në qoftë se veprimtarinë e tyre ose një pjesë të saj e ushtrojnë në të njëjtin treg përkatës ose në tregun e lidhur (“adjacent market”).

4. Me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të nenit 4/1 të këtij ligji, një ndërmarrje nuk mund të vlerësohet si ndërmarrje e vogël apo e mesme, nëse 25 për qind ose më shumë e kapitalit apo e të drejtave të votës kontrollohen, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, bashkërisht ose individualisht, nga një ose më shumë organe publike.

5. Ndërmarrjet mund të deklarojnë statusin e tyre, si ndërmarrje autonome, ndërmarrje partnere ose ndërmarrje e lidhur, përfshirë të dhënat, që lidhen me tavanet e përcaktuara në nenin 4 të këtij ligji. Deklarata mund të bëhet edhe në rastet kur kapitali është i shpërndarë në atë mënyrë që nuk është e mundur të përcaktohet se nga kush zotërohet. Në këtë rast, ndërmarrja mund të deklarojë, në mirëbesim, se nga asnjë ndërmarrje e vetme ose nga ndërmarrje të lidhura me njëra-tjetrën bashkërisht nuk zotërohet 25 për qind apo më shumë e kapitalit.

6. Mënyra e deklarimit të statusit të ndërmarrjeve, sipas pikës 5 të këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/5

1. Të dhënat, që zbatohen për numrin e të punësuarve dhe shumat financiare janë ato, që lidhen me periudhën e fundit të llogarive të miratuara dhe që llogariten në baza vjetore. Ato merren parasysh nga data e mbylljes së llogarive. Shuma e caktuar për të ardhurat llogaritet duke përjashtuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe taksat e tjera indirekte.

2. Kur në datën e mbylljes së llogarive ndërmarrja zbulon se, në bazë vjetore, ka tejkaluar ose ka rënë poshtë numrit të të punësuarve apo tavanit financiar, të përcaktuar në nenin 4 të këtij ligji, ajo nuk e përfton ose e humb statusin e ndërmarrjes së vogël, ndërmarrjes së mesme apo të mikrondërmarrjes, me përjashtim të rastit kur këto tavane tejkalohen për dy periudha llogaritjeje të njëpasnjëshme.

3. Në rastin e ndërmarrjeve të reja, llogaritë e të cilave nuk janë miratuar ende, të dhënat për t’u zbatuar duhet të përftohen nga një vlerësim, në mirëbesim, i bërë gjatë vitit financiar në vazhdim.

Neni 4/6

1. Numri i të punësuarve korrespondon me numrin e njësive vjetore të punës me kohë të plotë.
2. Puna e personave, të cilët nuk kanë punuar gjatë të gjithë vitit, puna e atyre, që kanë punuar me kohë të pjesshme, pavarësisht kohëzgjatjes dhe puna e të punësuarve sezonalë llogariten si fraksione të njësive vjetore të punës me kohë të plotë.
3. Staf i përbëhet nga:
 - a) punëmarrësit;
 - b) punëdhënësit;
 - c) partnerët, që angazhohen në një veprimtari të rregullt në ndërmarrje dhe që përfitojnë nga përparësitë financiare të ndërmarrjes;
 - ç) menaxherët – pronarë.
4. Punëtorët në stazh, femrat, para ose pas periudhës së shtatëzani, si dhe studentët, që angazhohen në trajnime profesionale me kontratë, nuk përfshihen në staf.

Neni 4/7

1. Në ndërmarrjet autonome, të dhënat, përfshirë edhe ato për numrin e të punësuarve, përcaktohen ekskluzivisht, në bazë të llogaritjeve të ndërmarrjes.
2. Duke përfshirë edhe numrin e të punësuarve, të dhënat e një ndërmarrjeje, që ka ndërmarrje partnere ose ndërmarrje të lidhura, përcaktohen në bazë të llogaritjeve dhe të të dhënave të tjera të ndërmarrjes ose, aty ku ato ekzistojnë, në bazë të llogarive të konsoliduara të ndërmarrjes, ose të llogarive të konsoliduara, në të cilat ndërmarrja është përfshirë, nëpërmjet bashkimit.
3. Mënyra e llogaritjeve të ndërmarrjeve, sipas këtij neni, përcaktohet me udhëzim të miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.

Neni 4/8

1. Të dhënat e referuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji u shtohen të dhënat e çdo ndërmarrjeje partnere të ndërmarrjes në fjalë. Mbledhja bëhet proporcionalisht me përqindjen në kapital ose të drejtat e votës, cilado qoftë më e lartë. Në rast kryqëzimi aksionesh, zbatohet përqindja më e lartë.
2. Të dhënat e parashikuara në pikën 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe në pikën 1 të këtij neni, u shtohen 100 për qind e të dhënave të çdo ndërmarrjeje, e cila është e lidhur, drejtpërdrejt apo tërthorazi, me ndërmarrjen në fjalë, kur këto të dhëna nuk janë përfshirë, nëpërmjet bashkimit të llogarive.
3. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 dhe 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjes partnere të ndërmarrjes në fjalë përftohen nga llogaritë e tyre dhe të dhënat e tjera të tyre të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohen 100 për qind e të dhënave të ndërmarrjeve, të cilat janë të lidhura me ato ndërmarrje partnere, përveç kur të dhënat e llogarive të tyre përfshihen nëpërmjet konsolidimit.
4. Për zbatimin e pikës 2 të nenit 4/7 të këtij ligji dhe pikave 1 e 2 të këtij neni, të dhënat e ndërmarrjeve, që janë të lidhura me ndërmarrjen në fjalë, duhet të përftohen nga llogaritë dhe të dhënat e tjera të tyre, të konsoliduara, nëse ekzistojnë. Këtyre u shtohen proporcionalisht të dhënat për çdo ndërmarrje të mundshme, partnere të asaj ndërmarrjeje të lidhur, përveçse kur ajo është përfshirë në llogaritë e konsoliduara, me të paktën një përqindje proporcionale me përqindjen e përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.
5. Kur në llogaritë e konsoliduara nuk shfaqen të dhënat për numrin e të punësuarve për një ndërmarrje të caktuar, numri i të punësuarve llogaritet duke bashkuar proporcionalisht të dhënat nga ndërmarrjet e saj partnere dhe duke shtuar të dhënat nga ndërmarrjet, me të cilat ndërmarrja në fjalë është e lidhur.
6. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr udhëzim në zbatim të këtij neni.”.

Neni 4

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Ministri përgjegjës për ekonominë përcakton kriteret për pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në këto programe, sipas neneve 9 e 10 të këtij ligji.”.

Neni 5

Ngarkohet ministri përgjegjës për ekonominë të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore në zbatim të neneve 4/4, 4/7 e 4/8 të këtij ligji.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6000, datë 12.1.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 12.1.2009
Doli nga shtypi më 14.1.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 28 lekë